



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Nr/Br.

Data/Datum.

PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH.nr. 508/17

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “RSM Company” - Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës së OE “Sinjali Sh.p.k” - Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe i vendbanimeve”, me nr prok: “616/17/063/521”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - / Komuna e Prishtinës / më datën 17.01.2017 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “RSM Company” - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe i vendbanimeve”, me nr prok: “616/17/063/521”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues / Komuna e Prishtinës /.

II. ANULOHET njoftimi për dhënie të kontratës i AK - / Komuna e Prishtinës /, lidhur me aktivitetin të prokurimit me titull: “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe i vendbanimeve”, me nr prok: “616/17/063/521” dhe lënda kthehet në **Ri-vlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: “RSM Company” - Prishtinë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:16.06.2017.

Hapja e ofertave është bërë me dt:17.07.2017, ku kanë marr pjesë pesë operator ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit është bërë me dt:30.11.2017, ku është rekomanduar për kontratë OE: “Sinjali sh.p.k” - Ferizaj.

Kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik “RSM Company” - Prishtinë, me dt:04.12.2017, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 05.12.2017 autoriteti kontraktues ka marr vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik, “RSM Company” - Prishtinë.

Operatori ekonomik ankues “RSM Company” - Prishtinë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 14 dhjetor 2017 me nr. 508/17 kundër njoftimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal i rrugëve dhe i vendbanimeve”, me nr prok: “616/17/063/521”, të zhvilluar nga Autoriteti Kontraktues “Komuna e Prishtinës” duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet 59 pika 4 dhe neni 60 pika 1.1 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 19.12.2017 ka autorizuar ekspertin shqyrtues, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtuese i OSHP-së, në raportin e dt: 29.12.2017 ka konstatuar se: Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit ka zbatuar procedure të hapur, kontrate për punë - kontratë publike kornize me vlerë të mesme, ndaj të cilës operatori ekonomik ankues "RSM Company" shpk nga Prishtina ka parashtruar ankese kundër njoftimit për eliminim të tyre, përkatësisht shpalljes së ofertës së tyre të pa suksesshme. Kundër këtij njoftimi, pala në ankese me datë 04.12.2017, përmes shkresës elektronike, ka paraqitur Kërkese për Rishqyrtim tek AK, me pretendimet ankimore se komisioni i vlerësimit ka gabuar me vendimin për shpërblim të ofertës së operatorit fitues "Sinjal" shpk nga Ferizaj, ngase sipas ankuesit kjo oferte ka qenë e papërgjegjshme. Në përgjigje të pretendimeve të palës, AK-KK Prishtinë me datë 05.12.2017 nxjerr Vendim me të cilin e refuzon ankesën si të pa bazuar. Pala ankuese pretendon se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 59, pika 3 dhe 4, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave, ngase ka shpallur të përgjegjshme kompaninë e cila nuk i ka plotësuar kriteret për oferte të përgjegjshme të publikuara me Dosje të Tenderit. Konkretisht, pala në ankese e konteston çmimin e ofruar prej 0.50 euro/kg të një artikulli në pozicionin 1.7- ngjyrës së verdhe (plastike e ftohte), të marrë nga kompania "Nuova Maric" nga Italia. Po ashtu pretendon se specifikimi teknik nuk ka qenë i nënshkruar siç është kërcuar me DT. Në këtë pikë, po sqarojmë se çmimet e veçanta të artikujve, qofshin ato edhe të ulëta jonormalisht, nuk mund të trajtohen ndaras, sepse nuk janë kriter i vlerësimit. Trajtimi i çmimit total të ofertës sipas LPP në fuqi e legjislacionit dytësor mund të konsiderohet si jonormalisht i ulët pas që të jenë përmbushur kushtet ligjore, por jo ndonjë pozicion i veçantë (shih nenin 3 të Rregullës B57 të KRPP-së). Për më tepër dëshmia që pala në ankese e ka siguruar se ky artikull në çmimet e furnizuesit është me çmim më të lartë, nuk afekton procesin e vlerësimit, sepse politika e formimit të çmimeve është qeshje ekskluzive e operatorit dhe ky fakt nuk ndikon në vlerësim të tenderit, me përjashtim të rasteve kur kjo kërkohet me Dosje të Tenderit. Metej, pala në ankese pretendon se AK ka bërë shkelje të nenit 60 - Kriteret për dhënien e kontratës, pasi që fituesi aktual nuk i plotëson kriteret e publikuara me DT. Konkretisht, pretendon se OE fitues nuk ka pas autorizim origjinal të prodhuesit për sinjalizim horizontal dhe vertikal e as autorizimin origjinal për pajisjet ndriçuese për sinjalizimin e vendkalimeve dhe paneleve për sinjalizim në afërsi të shkollave. Në përgjigje të këtij pretendimi vlerësojmë se autorizimi si dokument është ofruar në dosjen e tenderit, me elementet përshkruese themelore si, emri i kompanisë prodhuese, qëllimi i dhënies me identifikimin e nr. të tenderit për të cilin kërkohet, me datë nënshkrim e vule. Përtej këtyre shënimeve, as AK e as në nuk mund të bëjmë investigim mbi vërtetësinë e tij dhe si i tillë merret si dëshmi e vlefshme dokumentare. Kontestimi që ia bën pala në ankese këtij autorizimi, në një mënyrë demantohet edhe nga vete prodhuesi me shkresën e dt. 14 dhjetor 2017 - në anglisht drejtuar z.Berisha si përfaqësues i "RSM Company" ia bënë të (qartë se me transparencë e ka njoftuar se krahas tyre bashkëpunon edhe me "Sinjal Company" nga Kosova, të cilën po ashtu e furnizon me këto produkte që një vit. Ndërkaq, sipas korrespondencës vërejmë se prodhuesi "Tamburrini Alessandro" s.r.l. i shmanget përgjigjes së drejtpërdrejtë nëse ata e kanë lëshuar autorizimin, duke e konsideruar jo etike një kërkesë të tillë të konkurrentit. Pra, përfundimisht konsiderojmë se dokumenti është i vlefshëm dhe se me asgjë nuk mund të provohet se nuk është

siguruar nga prodhuesi i njëjtë italian. Edhe dokumenti i dyte i titulluar si " Konfirmim i furnizimit ", dt. 03 .07. 2017, i ka te gjitha elementet e një autorizimi te prodhimit dhe garanton zyrtarisht kualitetin e prodhimit te vet me përshkrim e shifër te veçante, me nr. e prokurimit, datën, nënshkrimin e vulën. Pra, edhe këtë dokument e vlerësojmë te vlefshëm, i cili i përmbush kërkesat e një autorizimi te prodhuesit, pavarësisht titullit te modifikuar. Prandaj, bazuar ne sqarimin e mësipërm vlerësojmë se pretendimi ankimor i palës ne këtë pikë është i pa bazuar”.

Operatori Ekonomik përmes parashtresës me shkrim të datës: 29.12.2017, ka njoftuar Panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtuese.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 17.01.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i OE tw rekomanduar për kontratë, eksperti profesional i OSHP-së, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z.Kamberi deklaroi: “Ne si OE ankues nuk pajtohemi asnjë pikë me mendimin e ekspertit. Pika parë,është sepse eksperti nuk e ka marr për bazë ankesën tonë lidhur me specifikat teknike që nuk kanë qenë të nënshkruara nga Sinjal shpk, kurse eksperti nuk e ka shqyrtuar fare këtë pikë. Pika tjetër është lidhur me autorizimin e paraqitur nga Sinjal shpk, autorizim i lëshuar kinse nga kompania Tamburini, e cila në Header-Kokën e tij, përmban të dhënat e kompanisë Tamburini ndërsa poshtë te emri përfaqësuesit Domenico Bagazolli shkruan Nova Marik e cila është kompani tjetër. Po ashtu ky autorizim nuk është i vulosur prej kompanisë dhe nënshkrimi nuk është i Dominico Bagazoli. Si provë për krahasim ia ofroj panelit autorizimin tonë i nënshkruar nga Dominico Bagazoli i cili është njëkohësisht pronar i kompanisë Olga dhe Nuova Marik. I cili autorizim përmban edhe vulën e këtyre dy kompanive. Po ashtu pika tjetër që nuk pajtohemi me ekspertin është lidhur me ofertën e paraqitur nga kompania Nuova Marik kur i kanë kërkuar për sqarim të çmimit, pika jonë e ankesës ka qenë lidhur me atë ofertë të paraqitur e cila nuk është reale, dhe nuk është me çmime valide që ofron Nuova Marik, të njëjtën na e kanë vërtetuar edhe Nuova Marik, të dy çmimore të njëra prej Sinjal dhe ajo reale e dërguar Nuova Marik gjenden në materialin ankues. Pika e fundit, është lidhur me dokumentin e paraqitur nga Sinjal shpk, dokument i cili edhe prej ekspertit është sqaruar se është konfirmim i blerjeve të materialeve nga kompania 3M, që edhe në përshkrimin e saj thotë që sinjal shpk ka blerë materiale të 3M për shenja të trafikut në periudhën 1.01.2017 deri me 30.06.2017. pra ky nuk është autorizim ashtu siç

ka kërkuar AK, ky është vetëm konfirmim se Sinjal ka blerë materiale në një periudhë të caktuar. Në qoftë se shkojmë me këtë formë të tenderimit atëherë mund të bashkëngjisim dëdë doganor, fatura dhe këto dokumentet që kërkon AK”.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-KK Prishtinë z.Kamberi deklaroi: “Të gjitha pikat që OSHP e ka rekomanduar AK-KK Prishtinë për rivlerësim, AK-KK Prishtinë iu ka përmbajtur këtyre pikave, dhe përgjigjet e OE Sinjal shpk edhe eksperti shqyrtues i ka marr si të bazuara. Andaj ne si AK rekomandojmë panelit shqyrtues që të vazhdoj me tutje me mendimin e ekspertit shqyrtues për të përmbyllur këtë aktivitet të prokurimit. Sa i përket autorizimit që OE ankues konstaton se nuk është në rregull, kur ajo vet me datë 14.12.2017 prodhuesit i është drejtuar me shkresë dhe ju ka bërë me dije se kompania bashkëpunon edhe me kompaninë Sinjal për furnizimin e produkteve në fjalë qe një vit.

Gjatë prezantimit në seancë eksperti shqyrtues z.Hoxha deklaroi: “Qëndroj prapa asaj që kam dhënë me shkrim në raport. Pika parë që u cek për specifika teknike të panëshkruar, sipas LPP-së është e definuar se cilat dokumente detyrimisht kërkohet të jenë të nënshkruara, andaj specifikimi teknik si pjesë e dosjes nuk parashihet detyrimisht të jetë i nënshkruar dhe mendoj se kjo çështje është në rregull dhe nuk e kam trajtuar këtu. Sa i përket një pozicioni me çmim që OE ankues pretendon se është dashtë të trajtohet si tender jo normalisht i ulët, e kam dhënë edhe me shkrim shumë qartë që nuk i plotëson kushtet që të trajtohet e tërë oferta si ofertë me çmime jo normalisht të ulëta, për arsye se nuk plotëson tri parakushte që jep rregullorja B57 e KRPP. Mundet një pozicion me qen me çmim ë të ulët, por në tërësi nuk janë plotësuar parakushtet të trajtohet e tillë. Sa i përket autorizimit kam pas disa rezerva, me gjithë atë këto dokumente i kam trajtuar me kujdes. Pikënisja në këto raste sa i përket dokumentacionit është përmbajtja që shihet, por nuk mund të shkojmë më tej në investigim as AK as eksperti pasi këto çështje tejkalojnë kompetencat. Ajo çka ka rëndësi, në dy autorizimet është pika referente se lëshohen për këtë tender. Kanë qenë po ashtu elementet tjera si nënshkrimet, vula etj, kështu që i kam marr si të mirëqena. Ekziston një shkresë si përgjigje që i është dhënë OE në ankesë, ku njoftohet se edhe kompania fituese edhe OE ankues dyja furnizohen qe një vit nga i njëjti prodhues dhe një formë thotë nuk është etike që ju me më detyru me dhënë shpjegime më shumë sa i përket sjelljes së prodhuesit. Shkresa fundit fakt se në titull nuk shkruan autorizim, mirëpo ka gjitha elementet e autorizimit, kjo shkresë mund shihet në shkresat e lëndës, ka referencat për cilin tender, ka nënshkrimet, emërtimi është çështje formatit që përdor kompania kështu un kam vlerësuar. Sa i përket shkresës së fundit, në atë shkresë prodhuesi shumë mirë i përgjigjet OE ankues se mos kërko llogari se për kën bënë furnizime kompania në fjalë”.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE znj.Kelmendi deklaroi: “Sa i përket ligjit, shumica biznesmenëve nuk janë jurista dhe çdo AK thotë se duhet plotësuar ajo çka kërkohet në dosje. Kjo sa i përket specifikave teknike. Emailat eksperti thotë se ka konfirmuar autorizimin dhe kjo nuk qëndron. Sa i përket 3M eksperti thotë se është çështje formati, mirëpo data se kur është furnizuar OE nuk është element i autorizimit. I propozojmë panelit që lëndën ta kthej në rivlerësim dhe sipas provave dhe fakteve OE Sinjal të shpallet e papërgjegjshme dhe të vazhdoj procesi i prokurimit”.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE të rekomanduar për kontratë Sinjal z.Rexhepi deklaroi: “Ne kemi autorizim dhe jemi përfaqësues të 3M, Nuova Marik, Tamburini dhe Olga. Nëse është e nevojshme ne mund të sjellim dokumentacion shtesë që të dëshmojmë se nuk jemi kompani e tillë që bënë falsifikime siç pretendon OE ankues dhe qëndrojmë pranë çmimeve që kemi dhënë. Sa i përket cmimores, ne deklarojmë se jo çdo kompani merr njëjtin çmim prej prodhuesve dhe varësisht prej blerjeve merr edhe çmimin. Gjitha ato që kemi dhënë në oferta janë në përputhje me dosjen”.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK znj.Bajrami deklaroi: “I propozojmë panelit shqyrtues të merr si të bazuar vendimin e AK-së”.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton dhe vlerëson se është i paqëndrueshëm pretendimi i OE ankues në lidhje me çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë, për arsye se sipas dispozitave të paragrafit 4 të nenit 61 të LPP-së, vlerësimi i çmimit është e drejtë e autoritetit kontraktues dhe në rastin konkret AK-ja nuk ka pasur dyshime në lidhje me çmimet e ofruara nga OE i rekomanduar për kontratë, mirëpo nëse eventualisht ka dilema në lidhje me çmimet e ofruara atëherë autoriteti kontraktues duhet të respektojë nenin 61 të LPP-së dhe rregullorën për çmime jo normalisht të ulëta.

Në lidhje me pretendimin e OE ankues, që ka të bëjë me vlefshmërinë e autorizimit të dorëzuar në ofertë nga OE i rekomanduar për kontratë, paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe dëgjimit të palëve në seancën dëgjimore, vlerëson se konform nenit 72 të LPP-së është e nevojshme të verifikohet autorizimi i prodhuesit të lëshuar për OE të rekomanduar për kontratë, për faktin se gjatë seancës u prezantuan prova të cilat janë kundërtënëse në raport me autorizimin e OE të rekomanduar për kontratë. Andaj, me qëllim të vërtetimit të origjinalitetit dhe autenticitetit të këtij dokumenti, paneli shqyrtues, e

obligon autoritetin kontraktues – Komunës e Prishtinës që ta verifikoj dokumentin në fjalë konform nenit 72 të Ligjit për Prokurim Publik.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK - "Komuna e Prishtinës"

1x1 OE - "RSM Company Sh.p.k"- Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.